

VENDIM
Nr. 580, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP-në, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:”.

b) Në shkronjën “b”, shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive, nëpërmjet topografëve të tyre.”.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Subjektet e përcaktuara si bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP-në për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:”.

b) Në shkronjën “c” shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive, nëpërmjet topografëve të tyre.”.

3. Në pikën 22, fjalët “... nga një subjekt i licencuar ...”, hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama